

NDËRTESTESA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHIFRA

• **Arkitekt:**
Lordi Riçard Roxhers
Konsorciumi i Arkitektëve:
Richard Rogers Partnership
sh.p.k., Londër,
dhe Claude Bucher, Strasbourg

• **Vlera:**
455 milionë franga
franceze

• **Sipërfaqja e përdorshme:** 28 000 m²,
ku përfshihen,
- 860 m² për sallën e madhe të seancave
gjiqësore
- 520 m² për sallën e vogël të seancave
gjiqësore
- 4 500 m² për sallat e mbledhjeve
- 16 500 m² për zyra

• **Numri i sallave të mbledhjeve:** 18 ku përfshihen:
- sala e madhe e seancave gjiqësore (243 vende + 49 për gjyqtarët
+ 22 për kërkuesit)
- sala e vogël e seancave gjiqësore (101 vende + 25 për gjyqtarët
+ 12 për kërkuesit)
- sallat e vendimmarrjes nga ana e Gjykatës (hapësira për 47-52 vende)
- sallat e mbledhjeve (mesatarisht 47 vende rreth tryezës, plus 52 në
pjesën e prapme)

• **Numri i zyrave:** Ndryshon (535 zyra)

• **Pajisje audio-vizuale:** Salla e shtypit (204 vende)
Salla e seminareve (104 vende)

• Pa harruar:

- 490 kilometra kablo elektrike
- 5 500 drita
- 10 km tubacione
- 500 metra konvejerë të dokumenteve
- 9 ashensorë/ashensorë mallrash
- 450 tonë skelet metalik
- 1 450 tonë betonarme
- 15 000 metra kub beton
- 2 800 metra linearë korniza dritareje të palëvizshme
- 4 pompa për ngrohjes
- 16 njësi të veçanta të ajrosjes
- 50 firma me 125 nënkontraktues
- 1 500 punëtorë
- 800 000 orë pune ndërtimore

MOS NGATËRRONI

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

Me seli në Luksemburg, kjo Gjykatë siguron pajtueshmërinë me të drejtën dhe rregullat e BE-së, interpretimin dhe zbatimin e traktateve që themelojnë Bashkimin Evropian.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Organ gjyqësor i Kombeve të Bashkuara me seli në Hagë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Tekst i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948 për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar.

Karta për të Drejtat Themelore

Tekst i Bashkimit Evropian për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, miratuar në vitin 2000.

INFORMACIONE TË TJERA

European Court of Human Rights

Public Relations

67075 Strasbourg cedex

France

www.echr.coe.int



Shkurtimisht

RRETH GJYKATËS



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

SQI



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 1959. Ajo merr vendime për kërkesat individuale ose ndërshtetërore, të cilat pretendojnë shkelje të të drejtave civile dhe politike të përcaktuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Që nga viti 1998 ajo ka vepruar si gjykatë me orar të plotë dhe individët mund t'i drejtohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në rreth pesëdhjetë vjet, Gjykata ka nxjerrë më shumë se 10 000 vendime. Këto vendime, të cilat janë të detyrueshme për vendet përkatëse, kanë sjellë si pasojë ndryshimin e legjislacionit dhe praktikës administrative në disa fusha. Praktika gjyqësore e Gjykatës e bën Konventën një instrument të fuqishëm e të gjallë për të përballuar sfidat e reja dhe për të fuqizuar shtetin e së drejtës dhe demokracinë në Evropë.

Gjykata është me qendër në Strasburg, në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut, e projektuar nga arkitekti britanik Lordi Riçard Roxhers në vitin 1994 – një ndërtesë imazhi i së cilës njihet në mbarë botën. Nga kjo ndërtesë, Gjykata monitoron respektimin e të Drejtave të Njeriut të 800 milionë evropianëve në 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, që kanë ratifikuar Konventën.

DATAT KRYESORE

5 maj 1949

Themelimi i Këshillit të Evropës

4 nëntor 1950

Miratimi i Konventës

3 shtator 1953

Hyrja në fuqi e Konventës

21 janar 1959

Anëtarët e parë të Gjykatës u zgjodhën nga Asambleja Konsultative e Këshillit të Evropës

23-28 shkurt 1959

Seanca e parë e Gjykatës

18 shtator 1959

Gjykata miraton Rregulloren e Gjykatës

14 nëntor 1960

Gjykata merr vendimin e parë në çështjen "Lawless" k. Irlandës

1 nëntor 1998

Hyrja në fuqi e Protokollit Nr. 11 të Konventës, që krijoi "Gjykatën e re"

18 shtator 2008


Gjykata shpall vendimin e 10.000-të

1 qershor 2010

Hyrja në fuqi e Protokollit Nr. 14, qëllimi i të cilit është të garantojë efektivitetin afatgjatë të Gjykatës

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një traktat ndërkombëtar në bazë të të cilit shtetet anëtare të Këshillit të Evropës premtojnë t'u sigurojnë të drejtat themelore civile dhe politike jo vetëm qytetarëve të tyre, por edhe çdo individ brenda juridiksionit të tyre. Konventa, e cila u nënshkrua më 4 nëntor 1950 në Romë, hyri në fuqi në vitin 1953.



GARANCITË DHE NDALIMET

Konventa mbron në veçanti:

- të drejtën për jetën,
- të drejtën për proces gjyqësor të rregullt,
- të drejtën për të respektuar jetën private dhe atë familjare,
- lirinë e shprehjes,
- lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe,
- të drejtën e pronës.



Konventa ndalon:

- torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtërues,
- skllavërinë dhe punën e detyruar,
- dënimin me vdekje,
- ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm, dhe
- diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë.

